

VENDIM
Nr.62, datë 3.2.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I RRUGËS
“TRANSBALLKANIKE”, VLORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9839, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i rrugës “Transballkanike” Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, shtetasi Albert Hamdi Veizi, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për 45 (dyzet e pesë) m², sipërfaqe ndërtimi, vlerësuar me çmimin 67 100 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë/m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 3 019 500 (tre milionë e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 3 019 500 (tre milionë e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 15.2.2010 dhe të përfundojë më 15.5.2010.

6. Pronari i listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilin është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, të kryejë likuidimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas pikës 5 të këtij vendimi, dhe të dokumentacionit të pronësisë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE
QË PREKET SI REZULTAT I RRUGËS “TRANSBALLKANIKE”**

Lloji i pasurisë së patundshme: objekt

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.Pas.	Sip. totale pron.	ZK	Objekte			Shënime
							Sip. (m ²)	Çmimi L/m ²	Vlefte në lekë	
1	Albert	Hamdi	Veizaj	5/39	45 ND	8604	45	67100	3019500	Konfirmuar nga ZRPP
		Totali					45		3019500	